**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA**
**KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË**
**MUNICIPAL OF ASSEMBLY SUHAREKË**
**SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d) lidhur me nenin 17, nenin 24 dhe nenin 40, shkronja (g) të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", e në mbështetje të nenit 2, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/2008", i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-108 "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2016" e në zbatim të Rregullores për taksa, tarifa dhe gjobat komunale, 01-Nr-110-79262, të datës 22.12.2023, dhe konform nenit 28 paragrafi 2 pika (c), nenit 29 paragrafi 2 pika (d) dhe nenit 59 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, Kuvendi i Komunës së Suharekës në mbledhjen e mbajtur me datën----------, miraton këtë:

**Projekt-V E N D I M**
Për lirimin nga pagesa e qiras dhe faljen e borxhit të pa paguar

Neni 1

1.1 Të gjitha familjet e Dëshmorëve të cilat janë duke i shfrytëzuar me qira banesat që janë në pronësi të Komunës së Suahrekës lirohen nga pagesa e qirasë.

1.2 Me këtë vendim bëhet falja e borxhit të pa paguar për qiran, për të gjithë familjet e Dëshmorëve të Komunës së Suharekës**.**

Neni 2

Me miratimin e këtij vendimi, do të shlyhen nga evidenca e borxheve të pa paguara për qiran të gjitha familjet e Dëshmorëve të Komunës së Suharekës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për shërbime pronsore juridike dhe kadastër dhe Drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet e Komunës së Suharekës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr. 03/2026, për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

**K U V E N D I I K O M U N Ë S– S U H A R E K Ë**

**01-Nr-_____**
**Më datë_____**

**Kryesuesi i Kuvendit**
**_____**
**Mr.ec Bexhet KUÇI**